



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Zl.Anr.50/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Pejë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Pejë, për shkak të vendosjes së posterave në shtyllë elektrike për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 25.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Pejë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Dega në Pejë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1,500.00 euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 23.09.2017, nga LVV, me të cilën pretendon se me datë 22 shtator, aktivistët e tyre kanë vërejtur se në Rrugën “Ramiz Sadiku” në Pejë, në një trafo stacion ishte vendosur poster i kandidatit për kryetar dhe kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal të Pejës nga radhët e subjektit politik LDK.

Sipas parashtruesit të ankesës, vendosja e materialit zgjedhor në objekte publike përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Në përgjigjen në ankesë, të datës 24.09.2017, LDK thekson se kjo shkelje ka mundur të ndodhë pa dashje nga aktivistët e subjektit të tyre dhe në mungesë të njohurive me dispozitat ligjore të zgjedhjeve.

Më tej në përgjigjen kanë shtuar se kanë ndërmarre masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se poster i kandidatit për kryetar dhe anëtarëve të tjerë për Kuvendin Komunal të Pejës nga radhët e

subjektit politik LDK është vendosur në shtyllë publike- trafo stacion, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për Kryetar Komune dhe kandidatëve për Kuvend Komunal të Pejës nga radhët e subjektit politik LDK është vendosur në shtyllë publike-trafostacion. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë subjekti politik , në përgjigjen në ankesë të datës 24.09.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur mirëpo në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes sepse në fotografinë e bashkangjitur si provë në përgjigje rezulton të jetë i njëjti vend si në fotografinë e bashkangjitur në ankesë nga parashtruesi i ankesës ku pretendohet se është bërë shkelja, i cili veprim ka ndikuar në e lartësisë së gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl. Anr. 50/2017 më datën 25.09.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.